



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planim / Dorezuar Prilbjen / Prilbulo Received / Delivered	01.09.2023	3	viti god Year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot B. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	5909/2023		1/10



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA

INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1006/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1006/2023 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit 28546/23 të datës 27.06.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë, dhe Njoftimit 28608/23 të datës 29.06.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1006/2023 e datës 19.07.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetët në fuqi Vendimi 28546/23 i datës 27.06.2023 Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë, si dhe Njoftimi 28608/23 i datës 29.06.2023 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë.

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrrisë duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 19.04.2023 ka shpallur Konkursin për Pranim me numër reference RN00011477, për emrin e grupit "Specialist të Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike", me afat për aplikim nga data 10.05.2023 deri me datë 24.05.2023, dhe në të cilën procedurë pranimi ka qenë i përfshirë edhe ankuesi (tutje vetëm ankuesi).

Ankuesi ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e vlerësimit të Konkursit me numër reference RN00011411, ndërsa i pa kënaqur me njoftimin për rezultatet e vlerësimit me numër protokolli 27303/23 të datës 20.06.2023 ku është renditet i katërti në listë, me gjithsejtë gjashtëdhjetë e

tetë pikë dy (68.2) pikë të arritura, më datën 21.06.2023 ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullores në fuqi lidhur me Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil.

Ndërsa Komisioni i Pranimit në Komunën e Vushtrrisë me Vendimin me numër protokollin 28546/23 të datës 27.06.2023 i ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e datës 21.06.2023 të ankuesit, dhe rrjedhimisht me datë 29.06.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore në kuadër të Komunës së Vushtrrisë ka lëshuar njoftimin me numër protokollin 28608/23 për rezultatet përfundimtare të vlerësimit.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër protokollin 28546/23 të datës 27.06.2023 të Komisionit të Pranimit dhe Njoftimin me numër protokollin 28608/23 të datës 29.06.2023, me datë 19.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollin 5280/2023 të në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullores në fuqi për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil gjatë zhvillimit të procedurave të konkursit për pranim me numër reference RN00011477 për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" në Komunën e Vushtrrisë.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 24.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vushtrrisë, ndërsa kjo e fundit me datë 02.08.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollin 1006/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankësën me numër protokollin 5280/2023 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 19.04.2023 të Komunës së Vushtrrisë, për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00011477 për emrin e grupit Specialist të Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Publike; Vendimin me numër protokollin 28546/23 të datës 27.06.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të vlerësimit me numër protokollin 28608/23 të datës 29.06.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; Ankesën e 21.06.2023 të F.M drejtuar Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë; Vendimin me numër protokollin 3477/2023 të datës 07.04.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 20.12.2022 të Komunës së Vushtrrisë, për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00010647 për emrin e grupit Specialist të Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës Inspektor i Shërbimeve Publike; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 24.07.2023 të KPMSHCK-së drejtuar Komunës së Vushtrrisë; Përgjigjen në ankesë me numër protokollin 1006/2023 të datës 02.08.2023 të Komunës së Vushtrrisë drejtuar KPMSHCK-së; E-mailin e datës 27.07.2023 të dërguar nga B.D për J.S; Vendimin me numër protokollin 720/23 të datës 09.06.2023 të Komunës së Vushtrrisë; Akt emërimit me numër protokollin 861 të datës 01.02.2011 të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë për B.D; Akt emërimit me numër AE.nr.20-035/02-0033822/22 të datës 01.02.230.06.2022 të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë për Q.H; Akt emërimit me numër AE.nr.20-035/01-0017003/22 të datës 01.04.2011 të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë për I.L.; ;

Akt emërimin me numër protokoll 695 të datës 25.01.2011 të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë për I.Z; Marrëveshjen me numër protokoll 02/23 të datës 05.01.2023 të lidhur mes Komunës së Vushtrrisë dhe R.K; Njoftimin për verifikimin paraprak me numër protokoll 24097/23 të datës 01.06.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; Listën e aplikantëve; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe listën e kandidatëve të refuzuar; Njoftimin për verifikimin paraprak përfundimtar me numër protokoll 24719/23 të datës 06.06.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; **Aplikacionin e datës 19.05.2023 të kandidatit A.M, së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës;** Diplomën me numër 23 të datës 19.05.2021 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti I Bujqësisë dhe Veterinarisë për A.M; Certifikatën me numër 09-121/1 të datës 23.01.2023 nga Universiteti "St.kliment Ohridski"-Bitola- Fakulteti I Shkencave-Bioteknike për A.M; Pasqyrën e llogarisë së trustit të A.M për periudhën 20.10.2021-16.05.2023; Kopjen e letërnjoftimit të A.M; Vërtetimin me numër protokoll 3574/23 të datës 23.01.2023 të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë për A.M; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 19.05.2023 të lëshuar nga Sistemi qendror I evidencës penale të Kosovës për A.M; **Aplikacionin e datës 16.05.2023 të kandidatit A.A, së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës;** Diplomën me numër 4139 të datës 28.07.2015 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti Filozofik për A.A; Diplomën me numër 1616 të datës 22.04.2021 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti Filozofik, me titullin Master I Sociologjisë për A.A; Certifikatën e licencimit me numër 653/20 të datës 16.11.2020 të lëshuar nga Këshilli I Përgjithshëm I Shërbimeve Spitalore dhe Familjare, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për A.A; Certifikatën e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe "IHAS" për A.A; Certifikatën e muajit Prill 2023 të lëshuar nga Instituti I Kosovës për Administratë Publike për A.A; Certifikatën e muajit Prill 2023 të lëshuar nga Instituti I Kosovës për Administratë Publike për A.A; Marrëveshjen për shërbime të veqanta me numër 3999 të datës 15.03.2017 të lidhur mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe A.A; Marrëveshjen për shërbime special me numër MMPJ/2018 të datës 01.10.2018 të lidhur mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe A.A; Marrëveshjen për shërbime të veqanta të lidhur mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe A.A; Letër ofertën e praktikës të datës 26.10.2020 të lidhur mes "UNDP" dhe A.A; Kontratën publike me numër protokoll 2458 të datës 01.12.2020 të lidhur mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe A.A; Pasqyrën e llogarisë së trustit të A.A për periudhën 18.06.2016-18.11.2021; Letër ofertën e praktikës të datës 20.04.2021 të lidhur mes "UNDP" dhe A.A; Kontratën e punës të datës 01.12.2010 të lidhur mes Avokat A.R dhe A.A; Kontratën e punës me numër protokoll 88/2022 të datës 07.04.22 të lidhur mes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe A.A; Letër rekomandimin e datës 14.02.2017 të V.RR për A.A; Kopjen e letërnjoftimit të A.A; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 02.02.2023 të lëshuar nga Sistemi qendror I evidencës penale të Kosovës për A.A; **Aplikacionin e datës 22.05.2023 të kandidatit A.R, së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës;** Diplomën me numër 169 të datës 30.12.2010 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës-Fakulteti I Shkencave të Aplikuara Teknike për A.R; Diplomën me numër 4846 të datës 30.08.2017 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Juridik për A.R; Certifikatën me numër 324/2009 të datës 20.11.2009 të lëshuar nga Qendra Rajonale për aftësim profesional për A.R; Pasqyrën e llogarisë së trustit të A.R për periudhën 01.08.200-12.05.2023; Vërtetimin me numër protokoll 12508/23 të datës 15.03.2023 të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë për A.R; Kopjen e letërnjoftimit të A.R; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 24.03.2023 të lëshuar nga Sistemi

qëndror I evidencës penale të Kosovës për A.R; *Aplikacionin e datës 24.05.2023 të kandidatit B.B, së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 3877 të datës 11.02.2016 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Juridik për B.B; Vërtetimin e kopjes nga origjinali me Nr.rend.7342/2019; Certifikatën e datës 10-11.02.2020 të lëshuar nga Instituti I Kosovës për Administratë Publikë për B.B; Akt emërimit me numër reference 333 të datës 28.12.2015 të lëshuar nga Sekretariati I Këshillit Gjyqësor të Kosovës për B.B; Certifikatën e datës 05.01.2017 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë për B.B; Marrëveshjen për shërbime të veqanta me numër protokoll 736 të datës 01.06.2018 të lidhur mes Komunës së Vushtrrisë dhe B.B; Marrëveshjen për shërbime të veqanta me numër protokoll 1521/18 të datës 06.12.2018 të lidhur mes Komunës së Vushtrrisë dhe B.B; Marrëveshjen për shërbime të veqanta me numër protokoll 739/2019 të datës 07.06.2019 të lidhur mes Komunës së Vushtrrisë dhe B.B; Akt emërimit me numër protokoll 1336/19 të datës 25.11.2019 të B.B; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 25.11.2019 të vendit të punës Zyrtar I gjendjes civile; Njoftimin për përfundimin e procedurës për lëvizje Brenda kategorisë me numër protokoll 26629 të datës 25.05.2022 të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë; Kopjen e letërnjoftimit të B.B; Formularin e rezultateve në punë të datës 01.02.2023 për B.B; Formularin e rezultateve në punë të datës 20.01.2022; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 24.05.2023 të lëshuar nga Sistemi qëndror I evidencës penale të Kosovës; *Aplikacionin e datës 24.05.2023 të kandidatës E.B-J, së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 353 të datës 03.07.2020 të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Juridik për E.B; Certifikatën e datës 18.12.2017 të "UNMIK"; Certifikatën e datës 25.11.2021 të OJQ "Access"; Certifikatën e datës 22.01.2018 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë; Vërtetimin e muajit Gusht 2022 të "Sëiss rent a car; Letër rekomandimit me numër protokoll 2201/22 të datës 13.01.2022 të Komunës së Vushtrrisë; E-mailin e datës 24.05.2023 të dërguar nga S.GJ për E.B; Kontratën e punës të datës 01.08.2022 të lidhur mes " OJQ Strategjia Rinore" dhe E.B; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 15.04.2014-04.01.2023; Referencën nga Gjykata Themelore e Mitrovicës- Dega në Vushtri; Referencën nga Gjykata Themelore e Mitrovicës; Kopjen e letërnjoftimit të E.B-J; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 19.05.2023 të Sistemit qëndror të evidencës penale të Kosovës; *Aplikacionin e datës 15.05.2023 të kandidatit E.M së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 308 të datës 01.06.2001 të Gjinnazit "Muharrem Bekteshi" Vushtri; Diplomën me numër 346 të datës 26.06.2008 të Universitetit të Prishtinës-Fakultetit Juridik; Diplomën me numër 7915 të datës 21.04.2022 të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Juridik; Vërtetimin e kopjes nga origjinali me LRP/Nr.Rend.10376/2022; Certifikatën e datës 27.05.2011 të "ECDL Kosova"; Vërtetimin me numër protokoll 769 të datës 31.07.2018 të Gjinnazit "Eqrem Qabej"-Vushtri; Vërtetimin e SHFMU "Rilindja"; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 29.12.2010-10.05.2023; Certifikatën nga "ECDL Kosova"; Letër reference të datës 29.12.2022; Letër reference të datës 28.12.2022; Kopjen e letërnjoftimit të E.M; Raportin e vlerësimit të performancës në punë të SH.F.M.U "Rilindja"; Vërtetimin e datës 12.05.2023 të Policisë së Kosovës; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 12.05.2023 të Sistemit qëndror mbi evidencën penale të Kosovës; *Aplikacionin e datës 23.05.2023 të kandidatës F.H, së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 006/0116 të datës 22.01.2016 të Kolegjit Fama; Certifikatën e datës 10.12.2004; Certifikatën nga "KFOS"; Certifikatën e datës 16.12.2018; Vërtetimin me numër protokoll 2901/23 të datës 17.01.2023; Vendimin me numër protokoll 62/16-01/H të datës datës 14.06.2016; Kopjen e letërnjoftimit të F.H; Letër reference të muajit

Shkurt 2011; Pasqyrën e llogarisë së trustit per periudhën 25.07.2007-12.01.2023; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 23.05.2023; *Aplikacionin e datës 16.05.2023 të kandidatit F.O së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 392/0714 të datës 04.07.2014 të Kolegjit Fama- Programi Kriminalistikë; Vërtetimin për përvojën dhe marrëdhënien e punës me V.nr. 01/22 të datës 29.12.2022; Kopjen e letërnjoftimit të F.O; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 11.12.2004-23.12.2022; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 21.12.2022; Certifikatën e shtetësisë me numër serik SH 10127532 të datës 21.12.2022; *Aplikacionin e datës 19.05.2023 të kandidatës F.B, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër protokolli 373 të datës 18.06.2010 të Sh.M "Hasan Prishtina" - Mitrovicë; Diplomën me numër 477 të datës 16.11.2015 të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" - Fakulteti I Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë; Diplomën me numër 73 të datës 10.02.2020 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" - Fakulteti I Teknologjisë Ushqimore, me titull Master I Shkencave në Teknologji, Specializim: Inxhinieri e Mbrojtjes së Mjedisit; Certifikatën e datës 24.01.2008; Certifikatën e datës 06.06.2008; Certifikatën e datës 06.07.2008; Vërtetimin e datës 21.12.2016; Certifikatën e datës 19.05.2017; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 03.01.2020; Kopjen e letërnjoftimit të F.B; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 18.02.2015-17.05.2023; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 19.05.2023; *Aplikacionin e datës 18.05.2023 të kandidatit G.J, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër protokolli 715 të datës 20.06.2000 të Sh.M "Muharrem Bekteshi" - Vushtri; Diplomën me numër 37/15 të datës 30.12.2015 të Kolegjit "Tempulli" - Trafiku Rrugor dhe Transporti; Diplomën me numër 010/20 të datës 01.09.2020 të Kolegjit "Tempulli" - Master i Arteve në Transport dhe Telekomunikacion; Licencën me numër 17.02.2022; Certifikatën e datës 07.06.2021; Referencën nga SH.P.K "Ylli-Pashtriku"; Vërtetimin me numër protokolli 480 të datës 20.11.2020; Letër rekomandimin e datës 04.05.2022; Letër rekomandimin e datës 05.03.2023; Kontratën e punës; Kopjen e letërnjoftimit të G.J; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 05.05.2023; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 17.12.207-16.05.2023; *Aplikacionin e datës 24.05.2023 të kandidatit P.M, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër protokolli 84 të datës 05.06.2002 të SH.M. "Eqrem Qabej" - Vushtri; Diplomën me numër 112/13 të datës 05.03.2013 të Kolegjit "AAB" - Programi Banka, Financa dhe Kontabilitet; Vërtetimin e kopjes nga origjinali me LRP/Nr.Rend. 2004/2023; Diplomën e datës 25.03.2001; Certifikatën e datës 15-16.10.2019; Certifikatën nga Qendra trajnuese "Mëso"; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 23.07.2004-31.12.2022; Vërtetimin me numër protokolli 47228/22 të datës 06.09.2022; Kopjen e letërnjoftimit të P.M; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 03.05.2023; *Aplikacionin e datës 10.05.2023 të kandidatit XH.J, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 1711 të datës 08.01.2013 të Universitetit të Prishtinës- Fakulteti Juridik; Diplomën me numër 1049 të datës 01.04.2016 të Universiteti të Prishtinës- Fakulteti Juridik, me titull Master në të Drejtën Penale; Certifikatën me numër 167 AE; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 28.06.2011-17.01.2023; Vërtetimin me numër 11/22 të datës 17.01.2022; Vendimin me numër 111-1/19 të datës 01.03.2019; Kopjen e letërnjoftimit të Xh.J; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 27.12.2022; *Aplikacionin e datës 21.05.2023 të kandidatit XH.T, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 1302/13 të datës 30.11.2013 të Kolegjit "AAB" - Programi Administratë Publike; Certifikatën me numër 173 të datës 20.05.2022; Certifikatën e datës 09.11.2018; Certifikatën me numër 050/2018 të datës 23.02.2018; Certifikatën e lëshuar nga "Bloodhounds"; Certifikatën

e lëshuar nga "USA"; Certifikatën e datës 30.06.2017; Certifikatën e datës 14.02.2014; Certifikatën me numër regj.130 të datës 28.09.2012; Certifikatën e datës 08.12.2010; Certifikatën e datës 10.07.2015; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 01.08.2002-17.05.2023; Vërtetimin e datës 08.05.2023; Kopjen e letërnjoftimit të XH.T; Raporti përfundimtar I vlerësimit vjetor të pjesëtarëve të FSK-së I datës 24.12.2021; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 21.05.2023; *Aplikacionin e datës 16.05.2023 të kandidatit F.M, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën e SH.M "Eqrem Qabej" Vushtrri me numër protokolli 305 të datës 12.06.2006; Diplomën me numër 198 të datës 27.02.2012 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës- Fakulteti I Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë; Diplomën me numër 152 të datës 22.10.2014 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti I Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë, me titull Master I Shkencave Teknike; Certifikatën me numër 145/2015 të datës 13.05.2015; Certifikatën me numër 293/2015 të datës 31.07.2015; Certifikatën me numër protokolli 315/16 të datës 18.07.2016; Certifikatën me numër 136/2016 të datës 15.04.2016; Certifikatën e muajit Gusht 2019; Certifikatën me numër reference 370/23 të datës 07.04.2023; Certifikatën muajit Tetor 2013; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 16.10.2013-11.05.2013; Vërtetimin me numër protokolli 407 të datës 22.01.2020; Vërtetimin me numër protokolli 5639 të datës 03.10.2019; Referencën me numër protokolli 58/20 të datës 20.10.2020; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 23.12.2022; Certifikatën me numër protokolli 293/2015 të datës 31.07.2015; Letër rekomanduese nga AUV-Mitrovicë; Kopjen e letërnjoftimit të F.M; CV-në e F.M; Certifikatën e lindjes me numër serik L 25036916 të datës 14.02.2023; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 12.05.2023; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 16.10.2013-11.05.2023; *Aplikacionin e datës 11.05.2023 të kandidatës E.J, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 4914 të datës 21.09.2017 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti Juridik; Certifikatën nga "UP SHIFT"; Certifikatën nga "Yputh Council of the U.S Embassy"; Certifikatën nga Insituti I Demokratik I Kosovës; Certifikatën nga "USAIDI"; Certifikatën nga "HLC- Kosova"; Certifikatën e datës 25.10.2018; Certifikatën nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës; Certifikatën nga "USAIDI"; Certifikatën për kryerjen e stazhit të praktikës me SKPK/DBNJ/Nr.08 të datës 17.04.2019 në Këshillin Prokurorial të Kosovës; Kontratën e shërbimeve të lidhur mes "GLPS" dhe E.J; Vendimin me numër protokolli 01-2023 të datës 20.03.2020; Kontratën e punës të datës 01.12.2010 të lidhur mes Përmbaruesit Privat S.K dhe E.J; Deklaratën e konfidencialitetit të datës 01.09.2020; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 17.08.2017-27.04.2023; Letër reference të datës 16.11.2017; Rekomandimin e datës 25.04.2018; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 10.05.2023; *Aplikacionin e datës 14.05.2023 të kandidatit M.D, së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës*; Diplomën me numër 34 të datës 19.12.2017 të lëshuar nga Universiteti I Mitrovicës "Isa Boletini"- Fakulteti I Teknologjisë Ushqimore; Kontratën e punës të datës 03.01.2020 të lidhur mes "RIKI NTP" dhe M.D; Kontratën e punës të datës 01.08.2022 të lidhur mes "Apetit SH.P.K" dhe M.D; Kontratën e punës të datës 01.08.2022 të lidhur mes "Apetit SH.P.K" dhe M.D; Kontratën e punës të datës 01.12.2010 të lidhur mes "RIKI NTP" dhe M.D; Kontratën e punës të datës 04.01.2021 të lidhur mes "RIKI NTP" dhe M.D; Kontratën e punës të datës 03.01.2022 të lidhur mes "RIKI NTP" dhe M.D; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 16.11.2016-10.05.2023; Kopjen e letërnjoftimit të M.D; Certifikatën nga "Apetit Group"; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 02.05.2023; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit F.M të vlerësuar nga Kryesuesi I Komisionit B.D; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023

të kandidatit M.D të vlerësuar nga Kryesuesi I Komisionit B.D; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatës E.J të vlerësuar nga Kryesuesi I Komisionit B.D; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit F.M të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit I.L; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatës E.J të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit I.L; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit M.D të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit I.L; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit F.M të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit I.Z; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatës E.J të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit I.L; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit M.D të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit I.L; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit F.M të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit Q.H; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatës E.J të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit Q.H; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit M.D të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit Q.H; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit F.M të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit R.K; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatës E.J të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit R.K; Formularin e Intervistës me gojë të datës 19.06.2023 të kandidatit M.D të vlerësuar nga Anëtari I Komisionit R.K; E-mailin e datës 09.06.2023 të dërguar nga J.S për të gjithë kandidatët; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 20.06.2023; Njoftimin për rezultatet e vlerësimit me numër protokollit 27303/23 të datës 20.06.2023; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të vlerësimit me numër protokollit 28608/23 të datës 29.06.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar, se Komuna e Vushtrisë bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 19.04.2023 ka shpallur konkursin për pranim me numër reference RN00011477, për emrin e grupit "Specialist të Administrimit të Përgjithshëm", për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" në kuadër të Drejtorisë për Inspektime, me afat për aplikim nga data 10.05.2023 deri me datë 24.05.2023, dhe ku si kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë:

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku tri (3) vite të studimeve.

Përvoja e punës së kërkuar: Së paku dy (2) vitë përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Komuna e Vushtrisë me qëllim të fillimit të procedurave të pranimit, duke u bazuar në nenin 34, paragrafi 12 dhe 13 të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publike, si dhe nenin 18 të Rregullores 16/2020 për Pranim dhe Karrierë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datë 09.06.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 720/2023 për formimin e Komisionit të Pranimit për konkursin me numër reference RN000011477, për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" në kuadër të Drejtorisë për Inspektime.

Tutje në konkursin për pranim me numër reference RN00011477 për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike", kanë aplikuar gjithsejtë tridhjetë e një (31) kandidatë, ndërsa me njoftimin për verifikimin paraprak përfundimtar me numër protokollit 24719/23 të datës 06.06.2023, gjashtëmbëdhjetë (16) kandidatë hyjnë listën e ngushtë, ndër ta edhe ankuesi, i cili ka qenë i

përfshirë në gjithë procedurat e vlerësimit të konkursit për pranim për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publikë", duke u renditur i katërti në listën përfundimtare me gjithsejtë gjashtëdhjetë e tetë pikë dy (68.2) pikë.

Ankuesi i pa kënaqur Vendimin me numër protokoli 28549/23 të datës 27.06.2023 dhe Njoftimin me numër protokoli 28608 të datës 29.06.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë respektivisht Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrise, lidhur me renditjen përfundimtare dhe zhvillimin e procedurave të konkursit për pranim për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publikë", me datë 19.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave ligjore dhe rregullores në fuqi për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil, gjegjësisht lidhur me përvojën e punës dhe arsimimin e kandidatëve të suksesshëm, shkeljet ligjore gjatë zhvillimit të intervistës me shkrim, vlerësimit jo meritör në intervistën me gojë dhe mos ruajtjen e dokumentave elektronike lidhur me ankesën në NJMBNJ.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se si kandidatë të suksesshëm të Konkursit me numer reference RN00011477, për dy pozita "Inspektor i Shërbimeve Publikë", në kuadër të Drejtorisë për Inspektime të Komunës së Vushtrrisë janë përzgjedhur me gjithsejtë nëntëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e pesë (91.75) pikë, dhe me gjithsejtë tetëdhjetë e pesë (85) pikë. Ndërsa ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me arsimimin dhe përvojën jo adekuate të kandidatëve të lartë cekur Kolegji gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se të njëjtit, respektivisht posedon titullin *Jursite e Diplomuar duke e dëshmuar me Diplomën me numër 4914 të datës 21.09.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti Juridik*, gjithashtu e njëjta e ka dëshmuar edhe përvojën e punës profesionale përmes *Pasqyrës së Llogarisë së Trustit* mirëpo edhe me kontratat e punës si vijon: *Certifikatën për kryerjen e stazhit të praktikës në vullnetare pa pagesë me SKPK/DBNJ/Nr.08 të datës 17.04.2019 në Këshillin Prokurorial të Kosovës nga data 01.03.2018 deri më datë 28.02.2019; Kontratën e shërbimeve Grupin për Studime Juridike dhe Politike "GLPS" nga data 03.06.2019 deri më datë 31.03.2020; Këshilltare Politike e Ministres së Drejtësisë më Vendimin me numër protokoli 01-203 të datës 02.03.2020 të Ministres së Drejtësisë; Kontratën e punës për kohë të caktuar/ të pa caktuar të datës 01.09.2020 të "Përmbaarues Privat"; Deklaratën e konfidencialitetit të datës 01.09.2020 tek "Përmbaarues Privat". Ndërsa kandidati i përzgjedhur, posedon titullin *Bachelor i Shkencave në Inxhinieri Ushqimore të dëshmuar me Diplomën me numër 34 të datës 19.12.2017 të lëshuar nga Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore*, gjithashtu dëshmon edhe përvojën profesionale me *Pasqyrën e Llogarisë së Trustit* dhe kontratat e punës si vijon: *Kontratë pune për kohë të caktuar nga data 01.01.2019 deri me datë 31.12.2013 në "RIKI NTP", në pozitën e punës Teknolog; Kontratën e pune për kohë të caktuar nga data 03.01.2021 deri më datë 31.12.2022 në "RIKI NTP", në pozitën e punës Teknolog; Kontratë punë për kohë të caktuar nga data 01.08.2022 deri më datë 01.08.2023 në "Apetit SH.P.K", në pozitën e punës Teknolog*. Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se arsimimi dhe përvoja e punës e kandidatëve të suksesshëm është në përputhje me kërksat e përgjithshme formale të konkursit për pranim, dhe rrjedhimisht në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Shtojca Nr.1/6 përcaktohet se: "Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1, ku përcaktohet se: IV.Kërkesat e përgjithshme formale: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të*

lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK); b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”, gjithashtu dhe me Shtojcën Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, ku përcaktohet se: “58.GR.Specialist i administrimit të përgjithshëm: Arsim i lartë i paspecifikuar”.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni i Pranimit me rastin shpalljes së Njoftimit me numër protokolli 28608/23 të datës 29.06.2023 për rezultatet përfundimtare të vlerësimit, dhe përzgjedhjen si kandidatë të sukseshëm me gjithësejtë nëntëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e pesë (91.75) pikë dhe gjithësejtë tetëdhjetë e pesë (85) pikë ka vepruar në pajtim me nenin 34 paragrafi 11 të Ligjit Nr.06/L-144, ku përcaktohet se: “Në përfundim të vlerësimit, kandidatët e vlerësuar me 70 për qind apo më shumë, të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe renditen nga Komisioni i pranimit, sipas pikëve të marra, në listën e kandidatëve të suksesshëm.” si dhe me nenin 25 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: “1.Përfundimi i konkurimit dhe shpallja e rezultatit Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj. 2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues.”

Lidhur pretendimin ankimor të ankuesit, i cili pretendon se gjatë zhvillimit të testimit me shkrim ka pasur shkelje ligjore, konkretisht përdorimit të telefonit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ankuesi nuk e ka dokumentuar me asnjë provë këtë shkelje ligjore, por vetëm tekstualisht, dhe si e tillë është e pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vlerësimit të pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me vlerësimin e intervistës me gojë nga Komisioni i Pranimit me gjithësejtë tre pikë dy (3.2) pikë, ka shqyrtuar provat e lëndës gjegjësisht *formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 19.06.2023*, nga secili anëtarë i Komisionit të Pranimit veq e veq dhe ka konstatuar se ankuesi është vlerësuar meritorisht dhe në pajtim me nenin 23 paragrafi 3, 4 dhe 5 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: “3.Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për Grupin përkatës që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 4.Intervista që zhvillohet është intervistë e strukturuar nga Komisioni i Vlerësimit i cili pëgatit apo zgjedh grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën me gojë të cilat përgaditen në ditën e zhvillimit të intervistës. 5.Vlerësimi maksimal për intervistën është deri në dhjetë (10) pike. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje.Vlerësimi për çdo kandidat është mesatarja vlerësimeve të gjithë anëtarëve”.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me ngarkimin dhe mungesën e dokumentave elektronike gjatë dërgimit të ankesës së tij tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në kuadër të Komunës së Vushtrrise, Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi lidhur me këtë, edhe pse në ankesën e datës 19.07.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil ankuesi tekstualisht citon: (Bashkangjitur gjeni dokumentin e ankesës së

dërguar NJMBNJ së bashku me dëshminë në sistemin SIMBNJ), mirëpo i njëjti e konfirmon Këshillën Juridike prej tre (3) ditësh afat ankese, të cilën e ka parashtruar me 21.06.2023, andaj Kolegji konstaton se Komisioni i Pranimit ka vepruar në pajtim me nenin 25 paragrafi 5 dhe 6 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankese të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje”,* pasi që i njëjti Vendimin e ka pranuar me datë 27.06.2023, dhe rrjedhimisht ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, theksuar si më sipër vlerëson se Komisioni i Pranimit në Komunën e Vushtrrisë me nxjerrjen e Vendimit me numër protokoll 28546/23 të datës 27.06.2023 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke vepruar në pajtim me nenin 25 paragrafi 6 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje.”*

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se procedurat e konkursit për pranimit numër reference RN00011477, për emrin e grupit *“Specialist të Administrimit të Përgjithshëm”*, të pozitës *“Inspektor i Shërbimeve Publike”* në kuadër të Drejtorisë për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë, janë zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1006/2023.

Ilire Mehmeti-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrise; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;